

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe mr.sc.Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses E.B., të cilën e përfaqëson R.K., - e ëma dhe klëtë, sipas autorizimit, R.K., avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës K.S., “S.”, me seli në Prishtinë, për zhdëmtimin material dhe jo material, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4264/2012, datë 24.03.2015, në seancën e mbajtur më 30.3.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës K.S., “S.”, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4264/2012, datë 24.03.2015, në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit jo material ndaj paditëses, për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar.

II Me pranimin e pjesshëm të revizionit të së paditurës, NDRYSHOHEN aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4264/2012, datë 24.3.2015, dhe ai i Gjykatës Komunale Skenderaj, C.nr.526/2011, datë 7.9.2012, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses E.B., nga fshati ..., për kompensimin e dëmit material për rehabilitim klimatik.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4264/2012, datë 24.03.2015, është aprovuar pjesërisht ankesa e të paditurës ashtu që është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Skenderaj, C.nr.526/2011, datë 07.09.2012, në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit jomaterial dhe material ndaj paditëses E.B., nga fshati ... dhe është obliguar e paditura KS “S” me

seli në Prishtinë, që paditëses E. B., për dhimbjet e pësuar fizike, t'ia paguajë shumën prej 3.000 €, për frikën e përjetuar - shumën prej 2.500 €, për zvogëlimin e aktiviteti jetësor për 15% - shumën prej 4.000 €, kurse për shëmtim trupor të një shkalle të lehtë - shumën prej 700 €, për ndihmën dhe kujdesin e huaj - shumën prej 200 €, për ushqim të përforcuar - 500€, për rehabilitim klimaterik - shumën prej 600€ dhe për dëmtimin e gardërobës - shumën prej 40 €.

a

Me pjesën II të dispozitivit, shumat e aprovuar janë ngritur me kamatë përkatëse ligjore, e cila llogaritet prej 7.9.2012 deri në pagesën përfundimtare, sipas normës së interesit që e paguajnë bankat komerciale për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar.

Me pjesën III të dispozitivit, është detyruar e paditura që shumat e aprovuara t'ia paguajë paditëses, përkatësisht përfaqësuesit të saj ligjor, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 997,00 €, në afat prej 15 ditësh, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Me pjesën IV të dispozitivit, kërkesëpadia e paditëses, përtej shumës së aprovuar, është refuzuar si e pabazuar.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura ka paraqitur me kohë revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjyqimet e të dy gjykatave të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Përgjigje ndaj revizionit ka paraqitur i autorizuari i së paditurës, me propozimin që të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, më datën 13.5.2011, në fshatin ..., në afërsi të shkollës fillore “I. B.”, ka ndodhur një aksident trafiku, të cilin me automjetin “...” me targa ..., e ka shkaktuar drejtuesi i tij, N. A., i cili, duke mos iu përshtatur kushteve të komunikacionit, shpejtësisë dhe pa kujdes të duhur ndaj këmbësorëve, me pjesën e përparme të djathtë të automjetit e godit paditësen e mitur, E. B., e cila me atë rast pëson lëndime trupore.

Nga ana e ekspertës së komunikacionit, ing.dipl.S. V., është vërtetuar se aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të drejtuesit të automjetit të siguruar tek e paditura, për shkak të mospërshtatjes me kushtet e trafikut (në vendin ku shpejtësia është e kufizuar me 20km/h), duke mos pasur kujdes ndaj këmbësorëve –nxënësve, në afërsi të shkollës, e godet paditësen, e cila në atë moment ka qenë duke kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë, në vendkalimin e shënuar të këmbësorëve, ku kishte përparësi kundrejt automjetit, të cilin e drejtonte i siguruari tek e paditura. Sipas gjetjeve të ekspertit, paditësja nuk ka pasur aftësi të mjaftueshme psikofizike t’i vlerësojë rreziqet e mundshme në trafik; duke pasur parasysh moshën e saj, ajo gjatë lëvizjes në trafik është dashur të ishte nën përkujdesjen dhe në prezencën fizike të prindërve ose të ndonjë personi të rritur, i cili do ta shoqëronte deri në shkollë.

Nga ekspertët mjekësorë, Dr. Xh.S., ortoped-traumatolog dhe Dr.Sh. M., psikiatër, është vërtetuar se paditësja E. B., në këtë aksident ka pësuar thyerje të dy kërcinjve të këmbëve. Këto lëndime nga ekspertët karakterizohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e lëndimeve të pësuar, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, zvogëlim të përgjithshëm të aktivitetit jetësor për 15%, shëmtim trupor të një shkalle të lehtë dhe ka pasur nevojë për kujdesin e një personi të tretë 70 ditë, për ushqim të përforcuar 100 ditë dhe për fizioterapi e rehabilitim klimaterik dy herë nga 10 ditë, në vitin e parë, dhe 1 herë në vit në vitin e dytë, pas aksidentit.

Gjykata e shkallës së parë, nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, duke u bazuar në dispozitën e nenit 146 par. 1 dhe nenit 142 par 2 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacion, ka vlerësuar se paditësja ka mundur të lëvizte pa përkujdesjen e personit të rritur dhe nuk ka pasur lëshime nga ana e saj, andaj ka konstatuar se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit, duke miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, ndërsa lartësinë e shumave e ka caktuar në bazë të dispozitës së nenit 323 të LPK, duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, intensitetin e frikës, shkallën e shëmtimit, zvogëlimin e aktivitetit jetësor, nevojën për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e huaj si dhe duke u bazuar në nenet 154, 158 dhe 4, si dhe nenet 195 dhe 200 të LMD, e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensojë dëmin jomaterial dhe material të caktuar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke gjykuar në procedurën ankimore, e ka miratuar si pjesërisht të bazuar ankesën e të paditurës, ashtu që kontributin e paditëses për shkaktimin e dëmit e ka vlerësuar në bazë të nenit 177 par 3 të LMD, në përpjesëtimin me 80% me 20% dhe, mbi këtë bazë e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si në pjesën I të dispozitivit, për sa i përket kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të paditëses për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit jetësor dhe shëmtimin trupor, si dhe për ndihmën dhe kujdesin e huaj, ushqimin e përforcuar, mjekimin klimaterik dhe dëmtimin e gardërobës. Mbi shumat e gjykuara ka caktuar kamatën e cila do të llogaritet prej 7.9.2012 deri në pagesën përfundimtare, sipas normës së interesit që e paguajnë bankat komerciale për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 997,00 €. Përtej shumave të miratuara, kërkesëpadia e paditëses është refuzuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kontributin e paditëses për shkaktimin e dëmit e ka vlerësuar në bazë të

nenit 177 par 3 të LMD në përpjesëtimin 80% me 20%. Mbi këtë bazë ka vlerësuar drejt se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, pasi që nga ana e ekspertës së komunikacionit, ing.dipl. S.V., është vërtetuar se edhe paditësja mban përgjegjësi për aksidentin e shkaktuar.

Për sa u përket shumave të aprovuara me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë për paditësen përkitazi me dhimbje fizike të përjetuara, frikën, shëmtimin dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, është zbatuar drejt dispozita e nenit 200 të LMD, lidhur me nenin 323 të LPK, përkitazi me caktimin e sasisë së dëmit jomaterial të precizuar në dispozitiv të aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, ngase shumat e aprovuara në emër të dëmit jomaterial janë caktuar në bazë të ekspertizës së ekspertëve mjekësorë, në të cilën përshkruhen lëndimet të cilat i janë shkaktuar paditëses në këtë aksident - intensiteti i dhimbjeve fizike, intensiteti i frikës si dhe shkalla e shëmtimit dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor.

Vlerësimi i shpërblimit (satisfaksionit) për dëmin jo material përfaqëson zbatim të së drejtës materiale. Me rastin e caktimit të shumave të shpërblimit për format e caktuara të dëmit jomaterial, gjykata, sipas nenit 200 të LMD, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që të mos favorizohen synimet që nuk janë në përputhje me natyrën e një shpërblimi të tillë të dëmit jo material dhe me qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parashikuara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditëses, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, shkallën e shëmtimit, sipas gjendjes së vërtetuar nga ana e ekspertëve, siç u tha më sipër, e duke pasur parasysh edhe praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e shpërblimit të dëmit jomaterial për paditësen të caktuara në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë reale dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në këtë dispozitë dhe në harmoni me praktikën gjyqësore për caktimin e dëmit jomaterial të kësaj natyre, pra gjykatat e kanë zbatuar drejt të drejtën materiale. Për arsyet e mësipërme, janë të

pabazuara parashtrimet në revizion se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë janë jo reale dhe në shpërpjesëtim me natyrën dhe pasojat eventuale të lëndimeve.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, edhe shpërblimi i dëmit material i caktuar për paditësen me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, është real dhe i bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit përkatës mjekësor, duke pasur parasysh nevojën dhe kohëzgjatjen e nevojës së paditëses për ushqim të përforcuar, për ndihmën e huaj si dhe dëmtimin e gardërobës. Për këto arsye dhe duke i mbajtur parasysh të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kjo Gjykatë i cilëson si të pabazuara thëniet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e të dyja gjykatave janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale për sa u përket shumave të aprovuara të dëmit material.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta përkitazi me shpërblimin që i është caktuar paditëses për rehabilitim klimaterik, ngase, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e tyre në këtë pjesë janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale (neni 224.1 të LPK-së), për arsye se kjo formë e dëmit është caktuar pa prova përkatëse materiale, me të cilat do të argumentohet fakti se paditësja ka pasur shpenzime të kësaj natyre, prandaj kjo Gjykatë vendosi si në pjesën II të dispozitivit të aktgjyimit të saj. Për arsyet e mësipërme, me të drejtë theksohet në revizion se kjo pjesë e aktgjyqimeve të të dy gjykatave janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Thëniet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme, për faktin se e paditura nuk saktëson në revizion se kuqëndrojnë këto shkelje, ndërsa kjo Gjykatë e shqyrton aktgjykimin e goditur brenda kufijve të shkaqeve të vëna në dukje në revizion (neni 215 të LPK).

Lidhur me thëniet e tjera në revizion, kjo Gjykatë vlerësoi se ato nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje juridike, për faktin se vërejtjet e tilla në këtë fazë të procedurës nuk mund të çojnë në një zgjidhje tjetër të çështjes.

Nga sa u tha më sipër dhe me zbatimin e dispozitës së neneve 222 dhe 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Më 30.3.2016, Rev.nr.73/2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani